



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 3495 prot

Vlorë më 26 / 12 / 2017

Vendim

Nr. 32 datë 20 / 12 / 2017

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFAT – MESEM
2019-2021 DHE BUXHETIT VJETOR 2019”**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga *Grupi i Menaxhimit Strategjik*, për hartimin e kalendarit të PBA 2019-2021, të Këshillit të Qarkut Vlorë, mbështetur në:

- Ligji nr.139/2015 date 17.12.2015*Për vet qeverisjen vendore *,neni 41 pika 1 .
- Ligjin nr.68 dt.2017“Per financat e vetqeverisjes vendore“.neni 33 pika 1.
- Ligji nr. 9936 date 26.06.2008“ për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;me ndryshimet e bëra.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.2 date 06.02.2012“ për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ,,
- * Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.10/1 dt 29.02.2017 * për përgatitjen e buxhetit vendor afat - mesëm 2018 - 2020*.
- * Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr.10/2 dt 13.07.2017 * për përgatitjen e buxhetit vendor afat - mesëm 2018 - 2020*.

V E N D O S I:

1. Të miratojë **kalendarin** “ për prcedurat standarte për përgatitjen e kërkesave të programit buxhetor afatmesëm 2019 -2021 dhe buxhetit vjetor 2019” sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik të Këshillit të Qarkut
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshill.

KRYETARI
Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me vendim nr 17 dt 04 / 01 / 2018



Kalendari për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe Buxhetit vjetor			
Nr. Rendor	Periodha	Aktivitetet	Axhenda e takimeve
1	Deri dt. 31.01.2018	Kryetari i Keshillit të Qarkut paraqet për shqyrtim dhe miratim në keshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për programin buxhetor afatmesëm 2019-2021.	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve I raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe paraqitja e raportit të Kryetari i Keshillit të Qarkut.
2	Deri dt. 01.03.2018	Keshilli i Qarkut miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave.	
3	Deri dt. 05.03.2018	Kryetari i Keshillit të Qarkut paraqet dhe paraqet për miratim në keshill tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara dhe në vlerësimet afatmesme të transferave të percaktuara në Udhezimin e përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, Ekipi për menaxhimin e programeve përgatit dhe paraqet të Kryetari i Keshillit të Qarkut tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
4	Deri dt. 15.03.2018	Keshilli i Qarkut miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	Jo më vonë se 5 dite nga miratimi i tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, kryetari i Keshillit të Qarkut miraton Udhezinin e përgatitjes të buxhetit dhe e shpërndan tek të gjitha njësive shpenzuese.
5	Deri dt. 01.06.2018	Kryetari i Keshillit të Qarkut i dërgon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm.	Deri në dt. 01.06.2018 dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në formë shkresore dhe elektronike projekt dokumenti i programit buxhetor afatmesëm.
6	Deri dt. 20.06.2018	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon pranë Keshillit të Qarkut raportin me mendime mbi projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm.
7	Deri dt. 30.06.2018	Keshilli i Qarkut shqyrton dhe miraton projektin e pare të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.	Kryetari i Keshillit të Qarkut I paraqet keshillit projektin e pare të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të shoqëruar me mendimin zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
8	Deri dt. 05.07.2018	Publikohet dokumenti i pare i programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 i miratuar.	Kryetari i Keshillit të Qarkut me masat për publikimin e dokumentit të pare të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të miratuar.
9	Deri dt. 20.07.2018	Keshilli i Qarkut miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021.	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve I raportit për tavanet përfundimtare të shpenzimeve bazuar në Udhezinin plotësues të përgatitjes së PBA dhe paraqitja e raportit të Kryetari. Kryetari pas vlerësimit të raportit ja paraqet këtë Keshillit të Qarkut për miratim.
10	Deri dt. 30.07.2018	Publikohet udhezimi plotësues i programit buxhetor afatmesëm 2019-2021.	Kryetari i Keshillit të Qarkut nxjerr udhezinin plotësues për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021.
11	Deri dt. 15.09.2018	Dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 i rishikuar dërgohet në Ministrinë e Financave.	Kryetari i Keshillit të Qarkut me masat për publikimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të rishikuar, organizon seanca degjimore me grupet e interesit dhe përgatit dokumentin e PBA të rishikuar për të dërguar në Ministrinë e Financave.
12	Deri dt. 30.11.2018	Kryetari i Keshillit të Qarkut paraqet projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe e paraqet atë për miratim në Keshillin e Qarkut.	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve I projektit përfundimtar të PBA dhe paraqitja të Kryetari. Kryetari pas vlerësimit të projektit përfundimtar të PBA ja paraqet këtë Keshillit të Qarkut për miratim.

13	Deri dt. 25.12.2018	Keshilli i Qarkut miraton projektin e programit buxhetor afatmesem 2019-2021 perfundimtar.	Kryetari i Keshilli i Qarkut mer masat per publikimin e dokumentit te plote te programit buxhetor afatmesem 2019-2021 perfundimtar te miratuar. Nje kopje e dokumentit te plote te Programit buxhetor afatmesem I dergohet Ministrise se Finanave.
14	Deri dt. 31.12.2018	Publikohet dokumenti i plote i programit buxhetor afatmesem 2019-2021 i miratuar.	
15	Deri dt. 30.11.2018	Kryetari i Keshillit te Qarkut pergatitbuxhetin per vitin 2019 dhe e paraqet ate per miratim ne Keshillin e Qarkut.	Pergatitja nga Ekipi i Menaxhimit te Programeve I projektibuxhetit per vitin 2019 dhe paraqitja te Kryetari.
16	Deri dt. 25.12.2018	Keshilli i Qarkut miraton projektibuxhetin vjetor 2019.	Kryetari i Keshilli i Qarkut pas miratimit te programit buxhetor afatmesem 2019-2021 perfundimtar mer masat per pergatitjen e projektibuxhetit 2019 dhe ja paraqit ate per miratim Keshillit te Qarkut
17	Deri dt. 10.01.2019	Publikohet Buxheti I Keshillit te Qarkut per vitin 2019 i miratuar.	Kryetari i Keshilli i Qarkut mer masat per publikimin e dokumentit te plote te buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2019 te miratuar. Nje kopje e buxhetit vjetor te Keshillit te Qarkut dergohet ne Ministrine e Finanave.

